



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.69/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli – kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Skender Çoçaj- anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër administrimit të procesit të numërimit dhe shpalljen si të vlefshme të fletëvotimeve të dërguar me postë nga votimi jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.01.2026, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZP.Anr.69/2025, e datës 08.01.2026, e parashtruar nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet të pranuar me postë pas datë 29.12.2025 dhe të përjashtoj nga numërimi të gjitha fletëvotimet të pranuar pas këtij afati përfshirë ato të pranuar me 02.01.2026 dhe 05.01.2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 08.01.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.69/2026 nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se në neni 96 të LZP, përcakton formën, kushtet dhe afatet e votimit jashtë Kosovës, sipas këtij neni, shtetasi me të drejtë vote që jeton jashtë Kosovës mund të votojë vetëm nëse aplikon dhe regjistrohet me sukses për votim jashtë Kosovës, ndërsa vota e dërguar me postë në kutinë postare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë pranohen vetëm deri të nesërmen e ditës së zgjedhjeve në orën 16: 00, me kusht që të ketë vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve.

Më tej në ankesë pretendohet se kjo dispozitë ligjore nënkupton qartë dhe pa asnjë ekuivok se afati i fundit për pranimin e fletëvotimeve me postë nga votimi jashtë Kosovës ka qenë data 29 dhjetor 2025, ora 16:00. Ligji nuk parasheh asnjë përjashtim nga ky afat, nuk autorizon asnjë organ administrativ që ta zgjasë apo modifikojë ato, dhe as nuk lejon vendosjen e kushteve alternative për pranimin e fletëvotimeve përtej këtij afati.

Megjithatë, KQZ, me datë 10.12.2025, ka nxjerrë Vendimin Nr. 01/3794-2025 për miratimin e rekomandimit për afatet dhe veprimet për dërgimin dhe pranimin e pakove me fletëvotime për votim me postë. Në shtojcën e këtij vendimi, në pikën 3, është përcaktuar se "duke marrë parasysh festat e fund vitit dhe vonesat e mundshme postare, tërheqja e pakove me fletëvotime nga kutitë postare të KQZ-së do të bëhet më datë 02.01.2026, respektivisht në ditën e parë pasuese të punës në se shërbimet postare nuk funksionojnë.

Në praktikë, kjo ka rezultuar me pranimin, shqyrtimin, numërimin dhe shpalljen si të vlefshme të fletëvotimeve me postë që kanë arritur në kutinë postare të KQZ-së pas datës 29.12.2025, përfshirë edhe fletëvotime të pranuar më 02.01.2026 dhe 05.01.2026, të cilat janë bartur në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Gjithashtu, më datë 07.01.2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmes një njoftimi publik të publikuar në faqen zyrtare ka bërë të ditur se në vazhdim të procesit të numërimit do të përfshihen fletëvotimet nga votimi përmes postës të tërhequra më 2 dhe 5 janar 2026 nga kutitë postare jashtë Kosovës dhe që deri më tani janë sjellë në Kosovë dhe se rnë 2 janar, nga 9 kutitë postare në Pragë, Londër, Paris, Zagreb, Stokholm, Stamboll, New York, Kanbera dhe Kopenhagë, janë tërhequr 8,180 pako të tjera me fletëvotime, ndërkaq më 5 janar, nga 13 kutitë postare, në: Tiranë, Berlin, Vjenë, Bernë, Bruksel, Hagë, Podgoricë, Oslo, Shkup, Otavë, Lubjanë, Romë dhe Prishtinë, janë tërhequr 11,867 pako me fletëvotime. Sipas këtij njoftimi, pjesa më e madhe e këtyre pakove janë sjellë në Kosovë dhe i janë nënshtruar verifikimit dhe vlerësimit. Prej tyre, janë aprovuar rreth 16 mijë dhe ato janë duke u numëruar dhe gjithashtu ende nuk janë sjellë në Kosovë edhe 3,185 pako me fletëvotime, që janë tërhequr më 2 dhe 5 janar nga kutitë postare në Paris (1,962), Berlin (633), Hagë (61), Podgoricë (125), dhe Otavë (404).

Neni 96 paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës është normë imperative dhe e detyrueshme, e cila përcakton një afat të prerë dhe të pakushtëzuar për pranimin e votave me postë nga votimi jashtë Kosovës. Ky afat nuk është i natyrës orientuese, por përben kusht thelbësor për vlefshmërinë e fletëvotimit.

KQZ, është organ administrativ kushtetues, kompetencat e të cilit janë të përcaktuara qartë me ligj. KQZ-ja nuk gëzon asnjë kompetencë ligjvënëse dhe nuk mund, në asnjë rrethanë, të modifikojë, pezullojë apo zëvendësojë normat e përcaktuara shprehimisht me ligj, përmes vendimeve apo rekomandimeve administrative, si në rastin konkret. Vendimi Nr. 01/3794-2025, në pjesën ku legjitimon pranimin faktik të fletëvotimeve përtej afatit ligjor, përbën tejkallim flagrant të autorizimeve ligjore dhe shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 96 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përmes këtij veprimi, KQZ-ja ka marrë rolin e ligjvënësit, duke ndryshuar në mënyrë të njëanshme dhe të paligjshme një dispozitë ligjore të qartë, kompetencë kjo që i takon ekskluzivisht Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Së pari, është thelbësore të theksohet se paligjshmëria e pranimin dhe procedimit të fletëvotimeve me postë pas afatit ligjor tashmë nuk përbën më një dyshim apo pretendim të bazuar në informacione jozyrtare, por është pranuar dhe konfirmuar shprehimisht nga vetë komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes njoftimeve të tij publike. Sipas njoftimit zyrtar të

publikuar më datë 07.01.2026, KQZ ka bërë të ditur se në vazhdim të procesit të numërimit do të përfshihen fletëvotimet nga votimi përmes postës të tërhequra nga kutitë postare jashtë Kosovës më datë 2 dhe 5 janar 2026, të cilat janë sjellë ose pritët të sillen në Republikën e Kosovës. Ky njoftim përbën argument të drejtpërdrejtë dhe të pakontestueshëm se KQZ ka pranuar dhe po administron fletëvotime që, sipas ligjit, nuk kanë asnjë bazë për t'u konsideruar të vlefshme, pasi janë pranuar pas datës 29 dhjetor 2025, ora 16:00, afat ky i përcaktuar shprehimisht dhe në mënyre imperative nga neni 96 paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhjet e

Sipas të njëjtit njoftim zyrtar, më datë 2 janar 2026 janë tërhequr gjithsej 8,180 pako me fletëvotime nga kutitë postare në disa përfaqësi diplomatike, ndërsa më datë 5 janar 2026 janë tërhequr edhe 11,867 pako të tjera nga 13 kuti postare shtesë. Pra, bëhet fjalë për mbi 20,000 pako me fletëvotime që janë tërhequr dhe proceduar pas afatit pa asnjë bazë normative në ligj. Për më tepër, KQZ ka njoftuar se ende nuk janë sjellë në Kosovë edhe 3,185 pako të tjera me fletëvotime, të cilat janë tërhequr po ashtu më 2 dhe 5 janar 2026 dhe për të cilat është paralajmëruar se do të procedohen në ditët në vijim si pjesë e rregullt e procesit të numërimit. Ky fakt e thellon edhe më tej shkeljen ligjore, pasi tregon qartë një praktikë të vazhdueshme dhe të qëllimshme të administrimit të fletëvotimeve jashtë afatit duke e shndërruar shkeljen nga një veprim i izoluar në një proces sistematik dhe të institucionalizuar.

Sipas parashtruesit të ankesës, KQZ ka krijuar një standard paralel dhe të paligjshëm të vlefshmërisë së votës, duke e relativizuar afatin ligjor dhe duke e bërë atë praktikisht të pavlefshëm. Një veprim i tillë cenon thelbin e procesit zgjedhor dhe e minon besimin publik në administrimin e drejtë dhe të barabartë të zgjedhjeve.

Pasojat e këtij administrimi të kundërligjshëm nuk janë thjesht teorike apo hipotetike, por janë tashmë konkrete, të matshme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në përbërjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas përditësimeve zyrtare të rezultateve zgjedhore dhe raportimeve publike, si rezultat i procedimit dhe numërimit të këtyre fletëvotimeve të pranuar pas afatit ligjor, Subjekti Politik PDK ka humbur tashmë një mandat parlamentar, duke rënë nga 23 në 22 ulëse në Kuvend. Ky fakt është reflektuar edhe në sistemin zyrtar të rezultateve të KQZ-së dhe është bërë publik më datë 07.01.2026.

Edhe më alarmuese është rreziku real dhe i menjëhershëm që, nëse vazhdon procedimi i mëtejshmë i fletëvotimeve të pranuar pas afatit ligjor, përfshirë edhe mbi 3,000 pako të tjera që ende nuk janë sjellë në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës të humbasë edhe një mandat shtesë parlamentar, duke zbritur në 21 ulëse. Një zhvillim i tillë do të ishte pasojë direkt e një procesi të paligjshëm administrativ dhe jo e një vullneti të shprehur në përputhje me ligjin nga trupi elektoral. Për këto arsye, ndërhyrja e PZAP, nuk është vetëm e justifikuar, por është e domosdoshme dhe urgjente për të parandaluar prodhimin e pasojave të pakthyeshme juridike dhe institucionale.

Në këto rrethana, çdo vonesë në ndërhyrjen e PZAP-it do të nënkuptonte tolerim të vazhdimi të një procesi të paligjshëm, i cili jo vetëm që cenon integritetin e zgjedhjeve, por prodhon efekte konkrete në shpërndarjen e mandateve parlamentare dhe në përfaqësimin politik të

qytetarëve. Për këtë arsye, kërkohet që PZAP të veprojë me prioritet maksimal dhe të shfrytëzojë kompetencat e tij ligjore për të ndaluar menjëherë numërimin dhe përfshirjen në rezultate të fletëvotimeve të pranuar pas datës 29.12.2025, ora 16:00.

Edhe pse kjo ankesë nuk parashtrohet drejtpërdrejt kundër vendimit të KQZ-së si akt administrativ, ajo ka për objekt procesin e numërimit dhe shpalljen si të vlefshme të fletëvotimeve të pranuar pas afatit ligjor, në QNR.

Administrimi i numërimit të fletëvotimeve që nuk plotësojnë kushtet ligjore për vlefshmëri përben shkelje të qartë të ligjit dhe cenon drejtpërdrejt integritetin e procesit zgjedhor.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur Njoftimi zyrtar i publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, më datë 07.01.2025.

Kanë propozuar që të aprovohet ankesa si e bazuar. Të urdhërohet KQZ që ta anulojë të gjitha fletëvotimet e pranuar me post të pranuar pas datës 29.12.2025, ora 16,00 dhe të përjashtoj nga numrimi të gjitha fletëvotimet me postë pas këtij afati, përfshirë ato të pranuar me 02.01.2026 dhe 05.01.2026. Të urdhërohet KQZ të bëjë rishikimin e rezultatit zgjedhor pa përfshirjen e këtyre fletëvotimeve në përputhje me nenin 13 par.12 nën par.12.2 të Rregullores nr.01/2025 për procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave.

Në përgjigje në ankesë KQZ ka theksuar se më datë 10.12.2025, KQZ nxori vendimin me numër 01/3794-2025 për miratimin e afateve dhe veprimeve operacionale për dërgimin dhe pranimin e pakove me fletëvotime përmes postës. Duke u bazuar në rekomandimin e Sekretariatit dhe duke marrë parasysh afatet e përcaktuara me vendimin e KQZ-së të datës (mbi kërkesat dhe specifikimet për shërbimet postare për votimin jashtë Kosovës), është konstatuar se për shkak të dështimit të kontraktimit të operatorit ekonomik për shërbime postare, afatet e parashikuara fillimisht nuk ishin më të realizueshme.

Në këto rrethana, me qëllim të garantimit të së drejtës së votës dhe përmbushjes së detyrimit për dërgimin e fletëvotimeve tek votuesit jashtë vendit, KQZ-ja ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e afateve për dërgimin e pakove. Vendimi specifikon po ashtu se tërheqja e pakove me fletëvotime bëhet me datë 02.01.2026, përveç në rastet kur shërbimet postare nuk operonin në këtë datë për shkak të festave të fund vitit dhe duke qenë se datat 3 dhe 4 janar ishin ditë vikendi, tërheqja duhej të bëhej në ditën pasuese të punës, përkatësisht më 05.01.2026.

Gjatë procesit të vendimmarrjes janë marrë parasysh vonesat që festat e fund vitit shkaktojnë në procesimin e kthimit të pakove nga 22 shtete të ndryshme drejt Kosovës. Kjo vendimmarrje është bazuar plotësisht në Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht në Nenin 5, paragrafin 6, i cili autorizon KQZ-në që, në proceset e zgjedhjeve të parakohshme, të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës dhe në pajtim me rrethanat e krijuara, Po ashtu si shembull pas komunikimit me Postën në Shtetin e Zvicrës të njëjtit kanë konfirmuar se data 29.12.2025 nuk ishte ditë pune dhe nuk mund të bëhej tërheqja e pakove me fletëvotime,

Vendimi i KQZ për shkurtimin e afateve, i miratuar më 10.12.2025, është miratuar me votat e të gjithë Anëtarëve të KQZ-së, për çka kishte pajtueshmëri në mesin e të gjithë Anëtarëve të

KQZ-së, dhe se përveçse nuk është kontestuar nga asnjë palë, ka orientuar secilin akterë që të veprojë në përputhje me këto afate të përcaktuara. Po ashtu, votuesit kanë qenë të njoftuar që para ditës së zgjedhjeve se deri në cilën datë duhet të arrijnë dërgesat postare nga vendi përkatës. Për të përmbushur parimet ligjore të para shikueshmërisë dhe të sigurisë juridike, vendimi ka qenë publik. Ndryshimi i rregullave pasi që janë pranuar zarfet cenon sigurinë juridike.

KQZ përmes Zyrtarëve të Përfaqësive Diplomatike ka realizuar procesin e tërheqjes së pakove me fletëvotime në disa faza përgjatë periudhës dhjetor 2025 janar 2026, duke përfshirë gjithsej 22 kuti postare në vende të ndryshme dhe në Kosovë.

Procesi nisi më 23 dhjetor 2025 me tërheqjet fillestare në Bernë (8,000 pako) dhe Berlin (10,511 pako), duke u pasuar më 29 dhjetor me një sasi shtesë prej 10,044 pakosh po ashtu nga Berlioni. Faza tjetër u realizua më 2 janar 2026, datë në të cilën u procesuan tërheqjet në një numër të madh qendrash ndërkombëtare si: Praga, Londra, Zagrebi, Stokholmi, Stambolli, Nju Jorku, Kopenhaga, Kanbera dhe Parisi.

Së fundmi, për shkak të festave dhe ditëve të vikendit, tërheqja u përmbyll më 5 janar 2026. Në këtë datë u realizua tërheqja në Prishtinë dhe në qendra të tjera si: Vjena, Brukseli, Oslo, Rëma, Lubjana, Budapesti, Shkupi, Tirana, Hagay Otava, Podgorica, si dhe sasi të mbetura nga Berna dhe Berlioni. Ky koordinim i datave reflekton përshtatjen e procesit operacional me funksionalitetin e shërbimeve postare dhe kalendarin e festave zyrtare, duke siguruar grumbullimin e pakove me fletëvotime nga të gjitha kutitë postare,

Më tej në përgjigje KQZ, sqaron se një praktikë e tillë është aplikuar edhe në Zgjedhjet Lokale 2025, përkatësisht në Raundin e dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave të mbajtur me datë 9 nëntor 2025, ku KQZ kishte vendosur që për shkak të afatit të shkurtë në dispozicion për votuesit që të kthejnë fletëvotimet, tërheqja të bëhej me datë 11.11.2025 dhe në vendet ku data 11.11.2025 ishte festë zyrtare tërheqja të bëhej në ditën vijuese të punës respektivisht me datë 12.11.2025.

Sipas Procedurës së QNR-së, pas vlerësimit të pakove me fletëvotime nga Shërbimi Votues, zarfet e fshehtësisë me fletëvotime vendosen në kuti të votimit me nga 300 fletëvotime sipas komunës në Kosovë të cilës i takon votuesi i regjistruar për votim jashtë Kosovës. Konkretisht, zarfet e fshehtësisë me fletëvotime janë ndarë në kuti të votimit për të cilat janë krijuar vendvotimet dhe janë procesuar për numërim. Në këtë kuptim, në numërimin e datës 7 janar, përveç fletëvotimeve të numëruara nga tërheqjet e bëra me datë 2 dhe 5 janar 2026, kishte edhe zarfe me fletëvotime të cilat i takonin tërheqjeve të mëhershme e të cilat nuk janë numëruar për faktin se ishin në numër të vogël dhe sipas Procedurës duhej të bashkohej me fletëvotime të njëjtës komunë nga tërheqjes e radhës deri në plotësimin e kriterit rreth 300 fletëvotime në një kuti apo vendvotim. Gjatë procesit të vlerësimit të pakove me fletëvotime përmes postës, janë refuzuar 149 zarfe të cilat kishin arritur në kutitë postare pas datës 27 dhjetor 2025.

Ndërsa lidhur me pretendimet e ankuesit, i cili i referohet praktikës së vendosur me Vendimin A.A. Nr. 17/2019, KQZ sqaron se ky precedent nuk është relevant për rastin në fjalë. Kjo vjen si pasojë e faktit se vendimi i cituar ishte nxjerrë në kohën kur ishte në fuqi Ligji Nr. 03/L-073,

i cili tashmë është shfuqizuar. Vendimi që kontestohet nga ankuesi bazohet në Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ka sjellë ndryshime substanciale, sa i përket votimit përmes postës; në afatet dhe kutitë postare jashtë Kosovës. Për rrjedhojë, parimet apo interpretimet e vjetra ligjore nuk mund të aplikohen në mënyrë analoge mbi dispozitat e ligjit të ri, i cili rregullon në mënyrë specifike dhe të ndryshme pranimin e pakove me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës.

Përcaktimi i afateve nga ana e KQZ-së nuk përbën vetëm një veprim administrativ të bazuar në Nenin 5, paragrafin 6 të Ligjit Nr. 08/L-228, por është një veprim i domosdoshëm për të garantuar parimin e gjithëpërfshirës dhe realizimin efektiv të së drejtës së votës, të garantuar me Nenin 45 të Kushtetutës së Kosovës, sepse në të kundërtën shkurtimi dhe kufizmi i afateve të tërheqjes do të rezultonte në pamundësinë teknike të mijëra votuesve jashtë vendit për të pranuar dhe kthyer fletëvotimet e tyre brenda kohës. Prandaj, përshtatja e kalendarit të tërheqjeve ishte mjeti i vetëm që mundëson përfshirjen e votuesve në procesin vendimmarrës, duke parandaluar përjashtimin e tyre de facto nga zgjedhjet.

Në përfundim, bazuar në shtjellimet e mësipërme, pretendimet e ankuesit janë të pabazuara. Njëkohësisht, ankesa e dorëzuar me datë 08.01.2026 është e pasafatshme, pasi konteston Vendimin e KQZ-së të datës 10.12.2025 dhe veprimet operationale të tërheqjes së pakove me fletëvotime të realizuara më 02 dhe 05 janar 2026.

Ankesa është e pas afatshme

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën me datë 08.01.2026, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet të pranuar me postë pas datë 29.12.2025 dhe të përjashtoj nga numërimi të gjitha fletëvotimet të pranuar pas këtij afati përfshirë ato të pranuar me 02.01.2026 dhe 05.01.2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

Paneli ka vlerësuar se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 119, paragrafi 1 të LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 08.01.2026, ndërsa shkelja e supozuar sipas ankuesit ka ndodhur me datën 02.01.2026 dhe 05.01.2026 duke qenë se ankuesi ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet të pranuar me postë pas datë 29.12.2025 dhe të përjashtoj nga numërimi të gjitha fletëvotimet të pranuar pas këtij afati përfshirë ato të pranuar me 02.01.2026 dhe 05.01.2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

Me që pala ankuese në ankesë ka kërkuar që të anulohen fletëvotimet me postë dhe të përjashtohen nga numërimi të gjitha fletëvotimet e pranuar me datë 02.01.2026 dhe 05.01.2026, pra që ndërlihet me datën e pranimin të fletëvotimeve me postë, në këto rrethana paneli vlerësoj se shkelja e supozuar sipas ankuesit ka ndodhur me 02.01.2026 dhe 05.01.2026, ndërsa ankesa është parashtruar me 08.01.2026, paneli vlerësoi se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor.

Paneli ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik PDK, është e pasafatshme edhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, ku parashihet që *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara”*.


Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”* PZAP-i vendosi që të hedhë ankesën e ankuesës pasi që ankesa është parashtruar si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 118 paragrafi 1 dhe 119 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP.Anr.69/2025, datë 09.01.2026

Kryesues i Panelit

Kujtim Pasuli



Këshillë Juridike; kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

AA.nr.4/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar, Qerim Ademaj dhe Lumni Sallauka anëtarë të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të administrimit të procesit të numërimit dhe shpalljen e vlefshme të fletëvotimeve të dërguar me postë nga votimi jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.69/2025, të datës 09.01.2026, në seancën e mbajtur më datë 14.01.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.69/2025, të datës 09.01.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.69/2025, të datës 09.01.2026, është vendosur: Hedhet si e pasafatshme ankesa ZP.Anr.69/2025, e datës 08.01.2026, e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulohet të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë pas datës 29.12.2025 dhe të përjashtojë nga numërimi të gjitha fletëvotimet e pranuar pas këtij afati, përfshirë ato të pranuar më 02.01.2026 dhe 05.01.2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025.



Kundër këtij vendimi, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës që të: Aprovojë ankesën e parashtruar pranë kësaj gjykate, të anulojë Vendimin e PZAP-së ZP.Anr.69/2025, të datës 09.01.2026, si të pabazuar, të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të anulojë të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë pas datës 29.12.2026, ora 16:00 dhe të përjashtoj nga numërimi të gjitha fletëvotimet me postë të pranuar pas këtij afati, përfshirë ato të pranuar më 02.01.2026 dhe 05.01.2026, si dhe të bëjë rishikimin e rezultatit zgjedhor pa përfshirjen e këtyre fletëvotimeve, në përputhje me nenin 13 paragraf 12 nënparagraf 12.2 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave apo në alternativë çështja të kthehet në rishqyrtim me udhëzimin që PZAP të vlerësoj ankesën e PDK në themel.

PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar, i konteston në tërësi thëniet ankimore dhe i propozon Gjykatës Supreme që ankesën e datës 13.01.2026, nga ankuesi subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër vendimit të PZAP-it ZP.Anr.69/2025, të datës 09.01.2026, të refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e ankimuar të PZAP.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë më datë 08.01.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.69/2026 nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendohet se neni 96 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton formën, kushtet dhe afatet e votimit jashtë Kosovës. Sipas këtij neni, shtetasi me të drejtë vote që jeton jashtë Kosovës mund të votojë vetëm nëse aplikon dhe regjistrohet me sukses për votim jashtë Kosovës, ndërsa votat e dërguara me postë në kutitë postare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Kosovë pranohen vetëm deri në ditën pasuese të ditës së zgjedhjeve, deri në orën 16:00, me kusht që të kenë vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve. Më tej, në ankesë pretendohet se kjo dispozitë ligjore nënkupton qartë se afati i fundit për pranimin e fletëvotimeve me postë nga votimi jashtë Kosovës ka qenë data 29 dhjetor 2025, ora 16:00.



Ligji nuk parasheh asnjë përjashtim nga ky afat, nuk autorizon asnjë organ administrativ që ta zgjasë apo modifikojë atë dhe as nuk lejon vendosjen e kushteve alternative për pranimin e fletëvotimeve përtej këtij afati.

Megjithatë, KQZ-ja, më datë 10.12.2025, ka nxjerrë Vendimin nr. 01/3794-2025 për miratimin e rekomandimit për afatet dhe veprimet për dërgimin dhe pranimin e pakove me fletëvotime për votim me postë. Në shtojcën e këtij vendimi, në pikën 3, është përcaktuar se, *“duke marrë parasysh festat e fundvitit dhe vonesat e mundshme postare, tërheqja e pakove me fletëvotime nga kutitë postare të KQZ-së do të bëhet më datë 02.01.2026, respektivisht në ditën e parë pasuese të punës, nëse shërbimet postare nuk funksionojnë”*. Në praktikë, kjo ka rezultuar me pranimin, shqyrtimin, numërimin dhe shpalljen si të vlefshme të fletëvotimeve me postë që kanë arritur në kutitë postare të KQZ-së pas datës 29.12.2025, përfshirë edhe fletëvotime të pranuar më 02.01.2026 dhe 05.01.2026, të cilat janë përfshirë në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

Gjithashtu, më datë 07.01.2026, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përmes një njoftimi publik të publikuar në faqen zyrtare, ka bërë të ditur se në vazhdim të procesit të numërimit do të përfshihen fletëvotimet nga votimi përmes postës të tërhequra më 2 dhe 5 janar 2026 nga kutitë postare jashtë Kosovës dhe që deri më tani janë sjellë në Kosovë dhe se më 2 janar, nga 9 kutitë postare në Pragë, Londër, Paris, Zagreb, Stokholm, Stamboll, Nju Jork, Kanberra dhe Kopenhagë, janë tërhequr 8,180 pako të tjera me fletëvotime, ndërkaq më 5 janar, nga 13 kutitë postare në Tiranë, Berlin, Vjenë, Bernë, Bruksel, Hagë, Podgoricë, Oslo, Shkup, Otavë, Lubjanë, Romë dhe Prishtinë, janë tërhequr 11,867 pako me fletëvotime. Sipas këtij njoftimi, pjesa më e madhe e këtyre pakove janë sjellë në Kosovë dhe i janë nënshtruar verifikimit dhe vlerësimit. Prej tyre janë aprovuar rreth 16 mijë dhe ato janë duke u numëruar, ndërsa ende nuk janë sjellë në Kosovë edhe 3,185 pako me fletëvotime, të cilat janë tërhequr më 2 dhe 5 janar nga kutitë postare në Paris (1,962), Berlin (633), Hagë (61), Podgoricë (125) dhe Otavë (404). Neni 96 paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është normë imperative dhe e detyrueshme, e cila përcakton një afat të prerë dhe të pakushtëzuar për pranimin e votave me postë nga votimi jashtë Kosovës. Ky afat nuk është i natyrës orientuese, por përbën kusht thelbësor për vlefshmërinë e fletëvotimit.

KQZ-ja është organ administrativ kushtetues, kompetencat e të cilit janë të përcaktuara qartë me ligj. KQZ-ja nuk gëzon asnjë kompetencë ligjvënëse dhe nuk mund, në asnjë rrethanë, të



modifikojë, pezullojë apo zëvendësojë normat e përcaktuara shprehimisht me ligj, përmes vendimeve apo rekomandimeve administrative, si në rastin konkret. Vendimi nr. 01/3794-2025, në pjesën ku legjitimon pranimin faktik të fletëvotimeve përtej afatit ligjor, përbën tejkalim flagrant të autorizimeve ligjore dhe shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 96 paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Përmes këtij veprimi, KQZ-ja ka marrë rolin e ligjvënësit, duke ndryshuar në mënyrë të njëanshme dhe të paligjshme një dispozitë ligjore të qartë, kompetencë kjo që i takon ekskluzivisht Kuvendit të Republikës së Kosovës. Së pari, është thelbësore të theksohet se paligjshmëria e pranimi dhe procedimit të fletëvotimeve me postë pas afatit ligjor tashmë nuk përbën më një dyshim apo pretendim të bazuar në informacione jozyrtare, por është pranuar dhe konfirmuar shprehimisht nga vetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes njoftimeve të tij publike. Sipas njoftimit zyrtar të publikuar më datë 07.01.2026, KQZ-ja ka bërë të ditur se në vazhdim të procesit të numërimit do të përfshihen fletëvotimet nga votimi përmes postës të tërhequra nga kutitë postare jashtë Kosovës më datë 2 dhe 5 janar 2026, të cilat janë sjellë ose pritet të sillen në Republikën e Kosovës. Ky njoftim përbën argument të drejtpërdrejtë dhe të pakontestueshëm se KQZ-ja ka pranuar dhe po administron fletëvotime që, sipas ligjit, nuk kanë asnjë bazë për t'u konsideruar të vlefshme, pasi janë pranuar pas datës 29 dhjetor 2025, ora 16:00, afat ky i përcaktuar shprehimisht dhe në mënyrë imperative nga neni 96 paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas të njëjtit njoftim zyrtar, më datë 2 janar 2026 janë tërhequr gjithsej 8,180 pako me fletëvotime nga kutitë postare në disa përfaqësi diplomatike, ndërsa më datë 5 janar 2026 janë tërhequr edhe 11,867 pako të tjera nga 13 kuti postare shtesë. Pra, bëhet fjalë për mbi 20,000 pako me fletëvotime që janë tërhequr dhe proceduar pas afatit ligjor, pa asnjë bazë normative në ligj.

Për më tepër, KQZ-ja ka njoftuar se ende nuk janë sjellë në Kosovë edhe 3,185 pako të tjera me fletëvotime, të cilat janë tërhequr po ashtu më 2 dhe 5 janar 2026 dhe për të cilat është paralajmëruar se do të procedohen në ditët në vijim si pjesë e rregullt e procesit të numërimit. Ky fakt e thellon edhe më tej shkeljen ligjore, pasi tregon qartë një praktikë të vazhdueshme dhe të qëllimshme të administrimit të fletëvotimeve jashtë afatit ligjor, duke e shndërruar shkeljen nga një veprim i izoluar në një proces sistematik dhe të institucionalizuar.

Sipas parashtruesit të ankesës, KQZ-ja ka krijuar një standard paralel dhe të paligjshëm të vlefshmërisë së votës, duke e relativizuar afatin ligjor dhe duke e bërë atë praktikisht të pavlefshëm. Një veprim i tillë cenon thelbin e procesit zgjedhor dhe e minon besimin publik në administrimin e drejtë dhe të barabartë të zgjedhjeve. Pasojat e këtij administrimi të



kundërligjshëm nuk janë thjesht teorike apo hipotetike, por janë tashmë konkrete, të matshme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në përbërjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Sipas përditësimeve zyrtare të rezultateve zgjedhore dhe raportimeve publike, si rezultat i procedimit dhe numërimit të këtyre fletëvotimeve të pranuar pas afatit ligjor, Subjekti Politik PDK ka humbur tashmë një mandat parlamentar, duke rënë nga 23 në 22 ulëse në Kuvend. Ky fakt është reflektuar edhe në sistemin zyrtar të rezultateve të KQZ-së dhe është bërë publik më datë 07.01.2026. Edhe më alarmues është rreziku real dhe i menjëhershëm që, nëse vazhdon procedimi i mëtejshëm i fletëvotimeve të pranuar pas afatit ligjor, përfshirë edhe mbi 3,000 pako të tjera që ende nuk janë sjellë në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës të humbasë edhe një mandat shtesë parlamentar, duke zbritur në 21 ulëse. Një zhvillim i tillë do të ishte pasojë direkte e një procesi të paligjshëm administrativ dhe jo e një vullneti të shprehur në përputhje me ligjin nga trupi elektoral. Për këto arsye, ndërhyrja e PZAP-it nuk është vetëm e justifikuar, por është e domosdoshme dhe urgjente për të parandaluar prodhimin e pasojave të pakthyeshme juridike dhe institucionale. Në këto rrethana, çdo vonesë në ndërhyrjen e PZAP-it do të nënkuptonte tolerim të vazhdimit të një procesi të paligjshëm, i cili jo vetëm që cenon integritetin e zgjedhjeve, por prodhon efekte konkrete në shpërndarjen e mandateve parlamentare dhe në përfaqësimin politik të qytetarëve. Për këtë arsye, kërkohet që PZAP-i të veprojë me prioritet maksimal dhe të shfrytëzojë kompetencat e tij ligjore për të ndaluar menjëherë numërimin dhe përfshirjen në rezultate të fletëvotimeve të pranuar pas datës 29.12.2025, ora 16:00.

Edhe pse kjo ankesë nuk parashtrohet drejtpërdrejt kundër vendimit të KQZ-së si akt administrativ, ajo ka për objekt procesin e numërimit dhe shpalljen si të vlefshme të fletëvotimeve të pranuar pas afatit ligjor në QNR. Administrimi i numërimit të fletëvotimeve që nuk plotësojnë kushtet ligjore për vlefshmëri përbën shkelje të qartë të ligjit dhe cenon drejtpërdrejt integritetin e procesit zgjedhor. Është propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, të urdhërohet KQZ-ja që të anulojë të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë pas datës 29.12.2025, ora 16:00, dhe të përjashtojë nga numërimi të gjitha fletëvotimet me postë pas këtij afati, përfshirë ato të pranuar më 02.01.2026 dhe 05.01.2026. Po ashtu, është kërkuar që KQZ-ja të urdhërohet të bëjë rishikimin e rezultatit zgjedhor pa përfshirjen e këtyre fletëvotimeve, në përputhje me nenin 13, paragrafi 12, nënparagrafi 12.2 i Rregullores nr. 07/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.



Në përgjigje në ankesë, KQZ-ja ka theksuar se më datë 10.12.2025 ka nxjerrë Vendimin nr. 01/3794-2025 për miratimin e afateve dhe veprimeve operationale për dërgimin dhe pranimin e pakove me fletëvotime përmes postës. Duke u bazuar në rekomandimin e Sekretariatit dhe duke marrë parasysh afatet e përcaktuara me vendimin e KQZ-së lidhur me kërkesat dhe specifikimet për shërbimet postare për votimin jashtë Kosovës, është konstatuar se për shkak të dështimit të kontraktimit të operatorit ekonomik për shërbime postare, afatet e parashikuara fillimisht nuk ishin më të realizueshme. Në këto rrethana, me qëllim të garantimit të së drejtës së votës dhe përmbushjes së detyrimit për dërgimin e fletëvotimeve te votuesit jashtë vendit, KQZ-ja ka bërë plotësimin dhe ndryshimin e afateve për dërgimin e pakove. Vendimi specifikon po ashtu se tërheqja e pakove me fletëvotime bëhet më datë 02.01.2026, përveç rasteve kur shërbimet postare nuk operonin në këtë datë për shkak të festave të fundvitit dhe, duke qenë se datat 3 dhe 4 janar ishin ditë vikendi, tërheqja duhej të bëhej në ditën pasuese të punës, përkatësisht më 05.01.2026. Gjatë procesit të vendimmarrjes janë marrë parasysh vonesat që festat e fundvitit shkaktojnë në procesimin e kthimit të pakove nga 22 shtete të ndryshme drejt Kosovës. Kjo vendimmarrje është bazuar plotësisht në Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht në nenin 5, paragrafi 6, i cili autorizon KQZ-në që, në proceset e zgjedhjeve të parakohshme, të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës dhe në pajtim me rrethanat e krijuara. Po ashtu, pas komunikimit me Postën në Shtetin e Zvicrës, është konfirmuar se data 29.12.2025 nuk ishte ditë pune dhe nuk mund të bëhej tërheqja e pakove me fletëvotime. Vendimi i KQZ-së për shkurtimin e afateve, i miratuar më 10.12.2025, është miratuar me votat e të gjithë anëtarëve të KQZ-së dhe nuk është kontestuar nga asnjë palë, duke orientuar të gjithë akterët që të veprojnë në përputhje me këto afate të përcaktuara. Votuesit kanë qenë të njoftuar para ditës së zgjedhjeve për datën deri në të cilën duhet të arrijnë dërgesat postare nga vendi përkatës. Për të përmbushur parimet ligjore të parashikueshmërisë dhe sigurisë juridike, vendimi ka qenë publik, pasi ndryshimi i rregullave pas pranimit të zarfeve cenon sigurinë juridike.

KQZ-ja, përmes zyrtarëve të përfaqësive diplomatike, ka realizuar procesin e tërheqjes së pakove me fletëvotime në disa faza gjatë periudhës dhjetor 2025 - janar 2026, duke përfshirë gjithsej 22 kuti postare në vende të ndryshme dhe në Kosovë. Procesi ka filluar më 23 dhjetor 2025 me tërheqjet fillestare në Bernë (8,000 pako) dhe Berlin (10,511 pako), duke u pasuar më 29 dhjetor me një sasi shtesë prej 10,044 pakosh po ashtu nga Berlini. Faza tjetër është realizuar më 2 janar 2026, kur janë procesuar tërheqjet në qendra ndërkombëtare si: Praga, Londra, Zagrebi, Stokholmi, Stambolli, Nju Jorku, Kopenhaga, Kanberra dhe Parisi. Së fundmi, për



shkak të festave dhe ditëve të vikendit, tërheqja është përmbyllur më 5 janar 2026, duke përfshirë Prishtinën dhe qendra të tjera si: Vjena, Brukseli, Oslo, Roma, Lubjana, Budapesti, Shkupi, Tirana, Haga, Otava, Podgorica, si dhe sasi të mbetura nga Berna dhe Berlioni. Ky koordinim i datave reflekton përshtatjen e procesit operacional me funksionalitetin e shërbimeve postare dhe kalendarin e festave zyrtare, duke siguruar grumbullimin e pakove me fletëvotime nga të gjitha kutitë postare.

Në vijim, KQZ-ja ka sqaruar se një praktikë e tillë është aplikuar edhe në Zgjedhjet Lokale 2025, përkatësisht në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, të mbajtura më 9 nëntor 2025, ku për shkak të afatit të shkurtër në dispozicion për votuesit për kthimin e fletëvotimeve, tërheqja ishte realizuar më 11.11.2025, ndërsa në vendet ku kjo datë ishte festë zyrtare, tërheqja ishte bërë në ditën pasuese të punës, përkatësisht më 12.11.2025. Sipas procedurës së QNR-së, pas vlerësimit të pakove me fletëvotime nga Shërbimi Votues, zarfet e fshehtësisë me fletëvotime vendosen në kuti votimi me nga rreth 300 fletëvotime sipas komunës në Kosovë, të cilës i takon votuesi i regjistruar për votim jashtë Kosovës. Konkretisht, zarfet e fshehtësisë janë ndarë në kuti votimi për të cilat janë krijuar vendvotimet dhe janë procesuar për numërim. Në këtë kuptim, në numërimin e datës 7 janar, përveç fletëvotimeve të numëruara nga tërheqjet e bëra më 2 dhe 5 janar 2026, ka pasur edhe zarfe me fletëvotime që i përkisnin tërheqjeve të mëhershme, të cilat nuk janë numëruar për shkak se ishin në numër të vogël dhe sipas procedurës duhej të bashkoheshin me fletëvotime të së njëjtës komunë nga tërheqjet e radhës deri në plotësimin e kriterit prej rreth 300 fletëvotimesh në një kuti apo vendvotim.

Gjatë procesit të vlerësimit të pakove me fletëvotime përmes postës, janë refuzuar 149 zarfe të cilat kishin arritur në kutitë postare pas datës 27 dhjetor 2025. Sa i përket pretendimeve të ankuesit lidhur me praktikën e vendosur me Vendimin A.A. nr. 17/2019, KQZ-ja ka sqaruar se ky precedent nuk është relevant për rastin konkret, pasi ishte nxjerrë në kohën kur ishte në fuqi Ligji nr. 03/L-073, i cili tashmë është shfuqizuar. Vendimi i kontestuar bazohet në Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ka sjellë ndryshime substanciale sa i përket votimit përmes postës, afateve dhe kutive postare jashtë Kosovës. Për rrjedhojë, parimet apo interpretimet e vjetra ligjore nuk mund të aplikohen në mënyrë analoge mbi dispozitat e ligjit të ri, i cili rregullon në mënyrë specifike dhe të ndryshme pranimin e pakove me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës. Përcaktimi i afateve nga ana e KQZ-së nuk përbën vetëm një veprim administrativ të bazuar në nenin 5, paragrafi 6 të Ligjit nr. 08/L-228, por është një veprim i



domosdoshëm për të garantuar parimin e gjithëpërfshirjes dhe realizimin efektiv të së drejtës së votës, të garantuar me nenin 45 të Kushtetutës së Kosovës. Në të kundërtën, shkurtimi dhe kufizimi i afateve të tërheqjes do të rezultonte në pamundësi teknike për mijëra votues jashtë vendit për të pranuar dhe kthyer fletëvotimet e tyre brenda kohës. Në përfundim, bazuar në shtjellimet e mësipërme, pretendimet e ankuesit janë të pabazuara. Njëkohësisht, ankesa e dorëzuar më datë 08.01.2026 është e pasafatshme, pasi konteston Vendimin e KQZ-së të datës 10.12.2025 dhe veprimet operationale të tërheqjes së pakove me fletëvotime të realizuara më 02 dhe 05 janar 2026.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të KQZ-së, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr.69/2025, të datës 09.01.2026, me të cilën e ka hedhur si të pasafatshme ankesën e subjektit politik ankues: Partia Demokratike e Kosovës (PDK), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

Në arsyetim të vendimit ka theksuar se: Paneli ka vlerësuar se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e saj, sipas nenit 119, paragrafi 1 të LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar. Ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 08.01.2026, ndërsa shkelja e supozuar, sipas ankuesit, ka ndodhur më datat 02.01.2026 dhe 05.01.2026, duke qenë se ankuesi ka kërkuar që të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të anulojë të gjitha fletëvotimet e pranuar me postë pas datës 29.12.2025 dhe të përjashtojë nga numërimi të gjitha fletëvotimet e pranuar pas këtij afati, përfshirë ato të pranuar më 02.01.2026 dhe 05.01.2026, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025.

Meqenëse pala ankuese në ankesë ka kërkuar që të anulohen fletëvotimet me postë dhe të përjashtohen nga numërimi të gjitha fletëvotimet e pranuar më datë 02.01.2026 dhe 05.01.2026, pra që ndërlidhen me datën e pranimit të fletëvotimeve me postë, në këto rrethana paneli vlerësoi se shkelja e supozuar, sipas ankuesit, ka ndodhur më 02.01.2026 dhe 05.01.2026, ndërsa ankesa është parashtruar më 08.01.2026. Për rrjedhojë, paneli vlerësoi se e njëjta është paraqitur pas afatit ligjor.

Paneli ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik PDK është e pasafatshme edhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 9, paragrafi 5 të Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, ku parashihet se: *"Personi mund të*



paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara". Neni 13, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 i Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it parashikon se: *"PZAP-i e hedh ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor"*. PZAP-i vendosi që ta hedhë ankesën e ankuesit, pasi që ankesa është parashtruar si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lart dhe duke u bazuar në nenin 118, paragrafi 1 dhe nenin 119 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 9, paragrafi 5, nënparagrafi 5.16, si dhe nenin 13, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Rregullores nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka hedhë poshtë si të pasafatshme ankesën e subjekti politik: Partia Demokratike e Kosovës. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, sepse në mënyrë të sigurt është vërtetuar se ankesa është dorëzuar në PZAP më datë 08.01.2026, ndërsa shkelja e supozuar sipas ankuesit ka ndodhur më datë: 02.01.2026 dhe 05.01.2026, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit ligjor të paraparë me nenin 119 paragrafi 1 të LKP-së.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, përkritazi me vlerësimin e gabuar të afatshmërisë së ankesës, keqinterpretimin e objektit të ankesës lidhur me shkeljen e supozuar, e cila sipas ankuesit duhet të jetë momenti kur fletëvotimet janë administruar, verifikuar, procesuar dhe shpallur të vlefshme nga QNR, zbatimin të gabuar të ligjit për afatshmërinë duke lidhur afatin për parashtrimin e ankesës me kohën e administrimit të fletëvotimeve dhe jo me datën e pranimit të tyre pas afatit ligjor të përcaktuar në nenin 96 par.2 të LKP-së, mungesën e kompetencës ligjore të KQZ-së për modifikimin e afateve ligjore, paligjshmërinë e procesit të numërimit dhe shpalljes së fletëvotimeve si të vlefshme, shkeljen sistematike dhe të



qëllimshme të procedurave nga KQZ, pasojat konkrete në ndarjen e mandateve parlamentare dhe referimin në praktikën gjyqësore të kësaj gjykate.


Me nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”*.

Me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.18 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, përcaktohet se: *“Personi mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve ankesë për shkeljet e pretenduara ditën e votimit, nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit”*

Me nenin 13 paragrafi 3 pika 3.2 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, me të cilën përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim: 3.2. nuk është dorëzuar në afatit e paraparë ligjor”*.

Prandaj nga kjo rrjedhë se vendimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimi i subjektit politik ankues se ankesa nuk është e pasafatshme është i pabazuar. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme përcakton qartë se afati prej 48 orësh fillon nga ndodhja e shkeljes së supozuar, e jo nga pasojat e saj të mëvonshme. Në këtë rast, vetë ankuesi e ka lidhur shkeljen me pranimin e fletëvotimeve pas datës 29.12.2025, duke kërkuar shprehimisht anulimin e fletëvotimeve të pranuar më 02.01.2026 dhe 05.01.2026. Për rrjedhojë, momenti i shkeljes së pretenduar identifikohet saktë me këto data, dhe ankesa e dorëzuar më datë 08.01.2026 është qartazi jashtë afatit ligjor. Pretendimi se objekti i ankesës nuk ka të bëjë me datën e pranimin të fletëvotimeve, por vetëm me trajtimin e tyre në numërim, nuk qëndron. Nga përmbajtja e ankesës rezulton qartë se kërkesa kryesore është anulimi i fletëvotimeve të pranuar pas afatit ligjor, konkretisht atyre të pranuar më 02 dhe 05 janar 2026. Këto data janë përdorur nga vetë ankuesi si bazë faktike e shkeljes së pretenduar. PZAP nuk ka bërë keqinterpretim, por ka



vlerësuar ankesën mbi bazën e përmbajtjes dhe kërkesave konkrete të saj. Në rastin konkret nuk ka keqinterpretim të dispozitave ligjore nga ana e PZAP-it sepse afatshmëria e ankesës është vlerësim i drejtë dhe i bazuar në ligj, pasi në raport me pranimin e votave nga jashtë pra votave me postë afati fillon të rrjedh nga data e pranimit dhe jo nga data e numërimit, pra shkelja nuk ka pasur mundësi të ndodh në procedurë të numërimit por në procedurë të pranimit, madje edhe subjekt ankues i referohet afatit të pranimit. Pra është paradoksale që afati të lidhet me ditën e numërimit sikurse pretendohet nga subjekti ankues, pasi në ditën e numërimit gjatë procesit të numërimit të votave nuk vlerësohet afati pasi me vet faktin e pranimit në ato data është konsumuar aspekti i afatshmërisë së pranimit, dje gjatë numërimit nuk është vërejt ndonjë shkelje me rastin e administrimit të procesit të numërimit, dhe nuk ka asnjë relevancë afatshmëria e pranimit me ditën e numërimit.

Subjekti ankues gjatë tërë procedurës pranë PZAP-it dhe në Gjykatë Supreme në raport me afatshmërinë e pranimit të votave me postë i referohet vendimit të KQZ-së por me ankesë pranë PZAP-it ka kërkuar që votat të shpallen të pavlefshme sepse janë pranuar pas afatit ligjor, mirëpo pranimi i votave në afatit sikurse ka rrjedh në procedurë derivon nga vendimi i KQZ-së mbi përcaktimin ndryshe të afatit e i cili vendim është miratuar në KQZ-së dhe i cili vendim nuk është atakuar nga asnjëri subjekt politik. Është e pakuptimtë që të kërkohej që votat e pranuar me postë të shpallen të pavlefshme e që vlefshmëria e tyre është si rezultat i vendimit të KQZ-së për përcaktimin e afatit ndërsa vendimi që ia jep këtë të drejtë KQZ-së për pranimin e këtyre votave të mbetet në fuqi, kjo është diskrepancë profesionale dhe ligjore.

Shkelja e pretenduar, sipas ankuesit, konsiston në pranimin e fletëvotimeve pas afatit ligjor si dhe në rrjedhjen e afatit për ankimim në procesin e verifikimit, administrimit dhe numërimit të fletëvotimeve dhe jo ardhja apo tërheqja e fletëvotimeve, të cilat kolegji i kësaj gjykate i vlerëson si të paqëndrueshme. Interpretimi i propozuar nga ankuesi do të cenonte rëndë parimin e sigurisë juridike dhe të parashikueshmërisë së procedurës ankimore. Nga gjithë përmbajtja e ankesës rezulton qartë që ankuesi konteston pranimin e fletëvotimeve me postë të dorëzuara siç thekson pas afatit të përcaktuar ligjor, dhe në asnjë pikë nuk i referohet parregullësive në numërim në mënyrë që afati të mund të lidhej me datën e parregullësive në numërim të fletëvotimeve. Pakënaqësitë eventuale të subjekteve politike nuk mund të shërbejnë si bazë për mohimin e të drejtës së votimit, përkatësisht numërimit të votave të pranuar më datë 02 dhe 5 janar 2026.



Pretendimi për shkeljen e nenit 96 par.2 të Ligjit nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës është pretendim që as Paneli Zgjedhor e as Gjykata Supreme nuk mund të vlerëson për arsye se ankesa pranë PZAP nuk është vlerësuar në merita të çështjes, pikërisht për shkak të pengesave ligjore respektivisht afatshmërisë së ankesës si prezumim procedural.

Pretendimi për humbjen e mandateve nuk mund të shërbejë si bazë për anashkalimin e afateve ligjore apo për legjitimimin e një anekse të pasafatshme. Pasoja politike nuk e shndërron një ankesë të vonuar apo një ankesë të paafatshme në një ankesë të pranueshme/afatshme.

Pretendimet e tjera të parashtruesit të ankesës janë pretendime që i referohen aspekteve meritore të cilat PZAP-i nuk i ka vlerësuar me të drejtë, sepse secila ankesë fillimisht ekzaminohet në drejtim të lejueshmërisë dhe afatshmërisë, dhe nëse rezulton se është e palejueshme apo e pa afatshme, PZAP-i e hedh poshtë pa u lëshuar në përmbajtje të ankesës dhe pretendimeve ankimore sikurse në rastin konkret. Të gjitha deklaratimet dhe pretendimet e subjektit ankues edhe sikur të qëndronin apo të merreshin të mirëqena nuk do të mund të shqyrtoheshin dhe ekzaminoheshin meqenëse aspekti i afatshmërisë është veprim paraprak i cili nuk ka mundësi të anashkalohej.

Afatet ligjore apo të parashikuara me akte ligjore apo nënligjore janë garanci për palën ankuese dhe detyrim për organet përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave brenda afatit kohor, ndërsa veçanërisht afatshmëria e ankesave në procesin zgjedhor është jetike për tu përmbyllur si i tillë dhe mos të ketë prolongime kohore.

Në këtë fazë të procedurës me rastin e shqyrtimit të ankesës së subjektit ankues në raport me pretendimet konkrete nuk ka kompetencë ligjore që as PZAP-i e as Gjykata Supreme të vlerësojë se vendimi i KQZ-së a është në kundërshtim me ligjin në drejtim të afatshmërisë së pranimi të votave me postë.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendosje ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.4/2026 me datë 14.01.2026

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Funçioni i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS / SUBSKI SAVET KOSOVA / KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

FILETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

Sheji i shkresës:
Oznaka spisa:

PD-4/2026

1. Pasi marrësi, i cili me kërkesë e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e kësaj detyre të bërë dorëzimit i sa pas lëvizës së llogaritit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendur në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës, së tij, dorëzimit është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtës, i qyt, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni pošte ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odaslom članu domaćin. Primac na svojiku zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primacem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresë u la në banesë në vendin e punës së marrësit (dike e ngjitur në detyrë e banesës ose të lokali ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaca (približno na vrata stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në orë _____
dana _____ u _____ cas.
Shkak i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - popis dostavljača

Numri i shkojçave:
broj priloga

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVITETI

14.04.2026

Vërtetohet se mora shkresën e llogaritit
me (me fjalë)
Povrdujem prijem govorevog pisma
(i slovima)

Atentat 13.04.2026
Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Popis primoca ili lic koje je
pismeno primio u zamenu

Nënshkrimi i dorëzuesit - popis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkallat pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.